



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

**Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve
vlerësuese për vlerësimin e Projekt - propozimeve të OJQ-ve: Aktivitetet e
MZHE-së**

Prishtinë: 28. 08. 2018

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, gjatë vitit 2018 planifikon që përmes thirrjeve publike të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare në fushat që ndërlidhen me :

1. Aktivitetet promovuese në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
2. Aktivitetet promovuese në fushën e energjisë;
3. Financimi i projekteve/ programeve të OJQ-ve në aktivitetet promovuese në fushën e ekonomisë dhe
4. Financimi i aktiviteteve vetëdijësuese dhe promovuese të fushës së edukimit në energji.

Rregullorja MF- Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, të pranuar sipas thirrjeve publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrimit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së MZHE-së, do të caktohen në cilësinë e anëtarëve të komisionit vlerësues për projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë përvojë punë që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor.
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: Arkivi.Mzhe@rks-gov.net, **deri më 12 Shtator 2018**. Aplikimin mund të bëhet edhe në kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, sheshi “Nëna Terezë”, nr 36.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik pasi të vlerësoj aplikacionet, do të formojë regjistrin e ekspertëve të jashtëm, të cilët do të ftohen sipas nevojës së komisionit vlerësues të MZHE-së për projektet propozimet e OJQ-ve.

Sinqerisht,